

DREJTORIA E AVOKATIT TË TATIMPAGUESIT

TË DREJTAT E TATIMPAGUESIT

- 01** E drejta për informim dhe asistencë
- 02** E drejta për konfidencialitetin e të dhënave
- 03** E drejta për njoftim
- 04** E drejta për kontrolle të arsyeshme
- 05** E drejta për informim
- 06** E drejta për përfaqësim
- 07** E drejta për të kërkuar evidenca me shkrim apo në rrugë elektronike
- 08** E drejta për t'u dëgjuar
- 09** E drejta e ankimit

DREJTORIA E AVOKATIT TË TATIMPAGUESIT

E DREJTA PËR INFORMIM DHE ASISTENCË

- 1** Çdo tatimpagues ka të drejtë që, me qëllim kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit tatimor, të marrë informacion dhe të asistohet pa shpërblim nga administrata tatimore. Brenda strukturës së administratës tatimore krijohen strukturat përgjegjëse për shërbimin e tatimpaguesve.
- 2** Çdo tatimpagues ka të drejtën e trajtimit të paanshëm, profesional dhe etik nga administrata tatimore, për çështje, që kanë të bëjnë me detyrimet tatimore.

DREJTORIA E AVOKATIT TË TATIMPAGUESIT

E DREJTA PËR KONFIDENCIALITETIN E TË DHËNAVE

- 1** Çdo tatimpagues ka të drejtën e konfidencialitetit për të dhënat e veta tatimore e financiare, të administruara nga administrata tatimore.
- 2** E dhënë tatimore dhe financiare është çdo informacion, i cili merret nga administrata tatimore, gjatë ushtrimit të funksioneve, tek tatimpaguesi ose palët e treta.

DREJTORIA E AVOKATIT TË TATIMPAGUESIT E DREJTA PËR NJOFTIM

Çdo tatimpagues ka të drejtë të marrë njoftim për çdo akt administrativ, veprim ose mosveprim, të bërë për mbledhjen e detyrimeve tatimore, i cili prek pasurinë e tij, me përjashtim të rasteve kur administrata tatimore vlerëson se ekziston rreziku real që, pas marrjes së njoftimit, tatimpaguesi ta transferonte pronësinë para përfundimit të vlerësimit tatimor.

DREJTORIA E AVOKATIT TË TATIMPAGUESIT

E DREJTA PËR KONTROLLE TË ARSYESHME

Tatimpaguesi ka të drejtë t'i sigurohen kontrole të arsyeshme, të cilat të kryhen në kohë të arsyeshme, në vendin e duhur dhe brenda afateve, sipas dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

DREJTORIA E AVOKATIT TË TATIMPAGUESIT

E DREJTA PËR INFORMIM

- 1** Në rastin e një mosmarrëveshjeje për vlerësimin tatimor, të bërë nga administrata tatimore tatimpaguesi ka të drejtë të marrë përgjigje me shkrim, në lidhje me arsyet dhe mënyrën e vlerësimit dhe të vendimit të marrë.
- 2** Në bazë të kërkesës me shkrim të tatimpaguesit, administrata tatimore lëshon vërtetim për të ardhurat e tatueshme, për detyrimet tatimore të mbetura, si dhe për pagesat e kryera nga tatimpaguesi.

DREJTORIA E AVOKATIT TË TATIMPAGUESIT

E DREJTA PËR PËRFAQËSIM

- 1** Tatimpaguesi ka të drejtë të emërojë një përfaqësues, me prokurë, i cili përfaqëson atë në raport me administratën tatimore.
- 2** Tatimpaguesi mbetet personalisht përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve tatimore edhe në rastin e emërimit të përfaqësuesit me prokurë.

DREJTORIA E AVOKATIT TË TATIMPAGUESIT

E DREJTA PËR TË KËRKUAR EVIDENCA ME SHKRIM APO NË RRUGË ELEKTRONIKE

Tatimpaguesi ka të drejtë të kërkojë nga administrata tatimore, në rrugë elektronike apo me shkrim, kopje të njësuara me origjinalin, për çdo dokument, që ndodhet në dosjen e hapur për të, apo të kërkojë kopje të printuara dhe të certifikuara të të dhënave elektronike, të lidhura me të.

DREJTORIA E AVOKATIT TË TATIMPAGUESIT
E DREJTA PËR T'U DËGJUAR

Tatimpaguesi, përpara marrjes së një vendimi administrativ për të dhe pasurinë e tij, ka të drejtën të dëgjohet nga administrata tatimore.

DREJTORIA E AVOKATIT TË TATIMPAGUESIT

E DREJTA E ANKIMIT

- 1** Tatimpaguesi gëzon të drejtën të ankohet dhe të sigurohet për një shqyrtim të pavarur administrativ të çështjeve të lidhura me të, në përputhje me kreun XIII, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
- 2** Tatimpaguesi gëzon të drejtën gjithashtu të ankohet në rrugë administrative, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, në Drejtorinë Rajonale Tatimore ose në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për çdo veprim apo mosveprim të punonjësve të administratës tatimore qendrore që shkelin të drejtat e tatimpaguesit.